

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kuvendi miratoi formulën e re të pagave, magjistratët nuk tërhiqen: Do e çojmë në Gjykatën Kushtetuese
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/kuvendi-miratoi-formulen-e-re-te-pagave-magjistratet-nuk-terhiqen-do--i104864
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 14:04:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 13:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2b94472fae1cacaef1658f49e616e63b7740a7ff95a6c79bd5c556da51bb7ba3
TEKSTI	0cbf2a888a31931f059f90c3a2fbad380fea00e2c99b792cd2766785233cc27e
PAMJA	3f0f83d911bc7b736db7f96fd494c63c6ed445b4fbd937515f081dceee323df1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	09f6757dd42b6148052c08e127659aa41bcc60bc33828452c0a69bb38caaf8fd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9c628a07075feceb8104ab280f983adfb76a5f01a86c5eb5ef058772798de17b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/09f6757dd42b6148052c08e127659aa41bcc60bc33828452c0a69bb38caaf8fd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

[reja për marrëdhënien](#)

se e rimëcoj, duke sjellë ndryshime të dukshme

prokurorëve: Ligjin do ta

Gjykatës Kushtetuese kundër

Durrës, shërbimi

Rinia në Durrës. Mësohet

grumbulluarve dhe talenti i edhe talenti i Bavarn

Izraelin. Pak më

Keni kërcënime

Kushtet, sfiduar pretendimi

AKTUALITET

Kuvendi miratoi formulën e re të pagave, magjistratët nuk tërhiqen: Do e çojmë në Gjykatën Kushtetuese

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 15:55



Shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve kanë kundërshtuar formulën e re të pagave të magjistratëve, të miratuar nga Kuvendi. Me anë të një deklarate të përbashkët, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, Shoqata e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë dhe Forumi i Grave Gjyqtare njoftojnë se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar pezullimin dhe shfuqizimin e ligjit.

Katër organizata shprehin bindjen e plotë në integritetin e procesit kushtetues dhe besimin se Gjykata Kushtetuese do të rivendosë standardet kushtetuese të cenuara. Ata theksojnë se kjo çështje nuk ka të bëjë me interesa financiare, siç është tentuar, në mënyrë të shtrembëruar, t'i paraqitet opinionit publik gjatë gjithë këtij procesi. Sipas organizatave, çështja lidhet me respektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, garantimin e pavarësisë së organeve të drejtësisë dhe mbrojtjen e themeleve të shtetit të së drejtës.

Deklarata

Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, Shoqata e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë dhe Forumi i Grave Gjyqtare të Shqipërisë shprehin vendosmërinë e tyre për të vijuar ndjekjen e procesit kushtetues lidhur me pagat e magjistratëve.

Me keqardhje kemi ndjekur procedurën parlamentare për miratimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'". Që në fillim, kjo procedurë është karakterizuar, në vlerësimin tonë, nga shkelje të kërkesave kushtetuese, duke nisur nga miratimi i projektligjit përtej afatit kushtetues, mungesa e një analize financiare nga Këshilli i Ministrave, mungesa e konsultimit efektiv dhe dëgjimi tërësisht formal i grupeve të interesit dhe, në fund, hyrja e menjëhershme në fuqi e ligjit.

Shoqatat tona mbeten të palëkundura në qëndrimin e tyre për rivendosjen e të drejtave kushtetuese të magjistratëve, të cilat janë cenuar haptazi nga ligji i miratuar në orët e mesnatës. Në këtë kuadër, informojmë opinionin publik se, me të njëjtën urgjencë me të cilën ky projektligj u shqyrtua, u miratua dhe u dekretua, do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit, shfuqizimin e tij si të papajftueshëm me Kushtetutën, si dhe shqyrtimin e çështjes me përparësi.

Kjo kërkesë bëhet e domosdoshme pasi, përmes këtij ligji, cenohet jo vetëm statusi financiar i magjistratëve, i cili është i lidhur ngushtësisht me garantimin e pavarësisë së tyre, por edhe vetë themelet e shtetit të së drejtës, për shkak të mosrespektimit të hapur të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese.

Shoqatat tona shprehin bindjen e plotë në integritetin e procesit kushtetues dhe besimin se Gjykata Kushtetuese do të rivendosë standardet kushtetuese të cenuara. Kemi besimin e plotë se do të jetë pikërisht procesi kushtetues ai që do të sqarojë çështjet e ngritura dhe do të hedhë poshtë përpjekjet për të diskredituar magjistratët dhe kërkesat e tyre legjitime.

Theksojmë edhe një herë se kjo çështje nuk ka të bëjë me interesa financiare, siç është tentuar, në mënyrë të shtrembëruar, t'i paraqitet opinionit publik gjatë gjithë këtij procesi. Ajo lidhet me respektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, garantimin e pavarësisë së organeve të drejtësisë dhe mbrojtjen e themeleve të shtetit të së drejtës. Për mbrojtjen e këtyre parimeve dhe vlerave kushtetuese, shoqatat tona mbeten të palëkundura dhe do të përdorin çdo mjet ligjor që Kushtetuta dhe ligji u vënë në dispozicion.

Ngërçi me pagat në gjyqësor

Kriza e pagave në sistemin e drejtësisë u përshkallëzua pasi Kuvendi nuk miratoi deri më 31 korrik formulën e re të pagave, në përputhje me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese. Pas skadimit të afatit,

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) vendosën që, nga 1 gushti, paga referuese të llogaritej mbi bazën e 222 mijë e 425 lekëve, duke i shtuar edhe 14 mijë lekë për kualifikimin. Megjithatë, Ministria e Financave nuk i ekzekutoi listëpagesat sipas kësaj formule, me argumentin se përcaktimi i pagave të magjistratëve dhe administratës së drejtësisë është kompetencë e Kuvendit.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 18 Shtator15:51

[Largoi 950 mijë euro verëra nga vila e Ergys Agasit, lihet në burg Eno Agasi](#)

Gjykata ka lënë në burg kushëririn e Ergys Agasit, Eno Agasin, i akuzuar se ka larguar verëra me vlerë 950 mijë euro nga vila...

AKTUALITET 18 Shtator15:47

[Pagat e magjistratëve/ Katër shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve: Ligjin do ta çojmë në Gjykatë Kushtetuese](#)

Shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve paralajmërojnë se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese kundër ndryshimeve ligjore p...

AKTUALITET 18 Shtator15:39

[Zjarr në një sipërfaqe me barishte në Durrës, shërbimi zjarrfikës i qytetit në luftë me flakët](#)

Një zjarr ka rënë në një sipërfaqe në Sektor Rinia në Durrës. Mësohet se shërbimi zjarrfikës i Du...

AKTUALITET 18 Shtator15:20

[Ndryshon vlera e zhdoganimit, do të paguhet më shtrenjtë për makinat e përdorura](#)

Ndryshojnë vlerat e zhdoganimit të automjeteve. Në Fletoren Zyrtare është botuar udhëzimi, që sjell rritje të ndjeshme t...

AKTUALITET 18 Shtator14:14

["Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la"/ Deputeti socialist humb bashkëshorten](#)

Loer Kume, deputet i Partisë Socialiste për Durrësin dhe prozator e eseist i njohur, ka njoftuar mesditën e kësaj të premte ndar...

AKTUALITET 18 Shtator14:12

[FSHZH lidh kontratën 8 milionë euro për transformimin e bregdetit të Durrësit](#)

Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka njoftuar lidhjen e kontratës me operatorin fitues FUSHA për projektin e transformimit të vijës bregdetare t...

AKTUALITET 18 Shtator14:10

[Ndryshime në Autoritetin e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, largohet Altin Jani, emërohet drejtori i ri](#)

Ermal Jauri është emëruar drejtor i ri i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Sigurisë së Informacionit të...

AKTUALITET 18 Shtator14:01

[Aksident/ Makina përplasat me barrierat, plagoset një grua dhe një fëmijë](#)

Një aksident i rëndë është regjistruar paraditen e sotme në aksin rrugor Elbasan- Peqin, ku dy persona kanë mbetur të ...

AKTUALITET 18 Shtator13:55

[Gjykata e Tiranës lë në burg Eno Agasin, dosja kalon për kompetencë në SPAK](#)

Gjykata e Tiranës vendos vijimin e masës "arrest në burg" për Eno Agasin dhe ka pranuar kërkesën e prokurorit Bledar...

AKTUALITET 18 Shtator13:47

[Po kujdesej për bimët narkotike në mes të pyllit, arrestohet 37 vjeçari në Mirditë](#)

Policia e Mirditës ka kryer disa kontrolle me dronë në zona të thella malore, me objektiv parandalimin dhe goditjen e kultivimit të b...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 18 Shtator

["Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la"...](#)

Loer Kume, deputet i Partisë Socialiste për Durrësin dhe prozator e eseist i njohur, ka njoftuar mesditën e kësaj të premte ndar...

AKTUALITET 17 Shtator

[Këta janë tre të rinjtë nga Fieri që humbën jetë...](#)

Një aksident tragjik ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në lagjen Glifadha të Athinës, ku kanë humbur jetë...

AKTUALITET 17 Shtator

[Ky është vendi i aksidentit tragjik ku humbën j...](#)

Ky është vendi ku tre të rinj humbën jetën në aksidentin rrugor në rrugën Poseidonos në Greqi, ndër...

INVESTIGIME 17 Shtator 17:59

[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues](#)

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pranë eum...


video



E premtë | ? 20:45 | Syri TV




E premtë | ? 20:45 | Syri TV



Çdo të premtë | ? 20:45 | Syri TV





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.